



Qendra për
Administrim Social
Ekonomik Territorial

Projekti: “Tirana, Zemra e Mesdheut”

Informacion mbi Qendrën ASET:

"Qendra për Administrim Social Ekonomik Territorial" (ASET) është një organizatë jo qeveritare dhe jo fitimprurëse e regjistruar në vitin 2014. Staf i qendres përbëhet nga ekspertë të kualifikuar me përvojë të gjatë në mbrojtjen, promovimin dhe advokimin e të drejtave të njeriut dhe grupeve vulnerable, gjithashtu me eksperiencë shumë të mirë në grumbullimin, hulumtimin dhe analizimin e të dhënave, ngritje kapacitetesh dhe shërbime ndaj grupeve vulnerable, promovimin e turizmit, kulturës dhe traditave.

Përshkrim i projektit:

Projekti “**Tirana, Zemra e Mesdheut**” ka për synim të sjellë një përvojë unike kulturore për banorët dhe vizitorët e Tiranës, duke krijuar një hapësirë ndërveprimi mes kulturave mesdhetare përmes turizmit. Nëpërmjet angazhimit të të rinjve, botimit të një albumi ekskluziv dhe organizimit të guidave turistike, projekti do të shndërrojë Tiranën në një pikë referimi për promovimin e trashëgimisë mesdhetare dhe do të ofrojë një mënyrë të re për të eksploruar historinë dhe traditat e vendeve të rajonit.

Një nga elementët më të veçantë të këtij projekti është përfshirja e 9 të rinjve, të cilët do të angazhohen si guida turistike dhe ambasadorë kulturorë, duke prezantuar për turistët dhe qytetarët e Tiranës trashëgiminë kulturore të 28 vendeve mesdhetare. Ata do të ofrojnë një përvojë të gjallë dhe ndërvepruese, duke shpjeguar ngjashmëritë dhe dallimet mes kulturave të rajonit përmes historive, traditave dhe zakoneve unike të secilit vend.

Kërkohet që kandidatët të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të njohë dhe të flasë shumë mirë gjuhë të huaj (Preferohet Anglisht/ Gjermanisht/Italisht)

Përgjegjësitë dhe detyrat:

1. Të rinjtë do të ofrojnë informacione mbi kulturën dhe traditat e vendeve mesdhetare për vizitorët/turistët
2. Shërbimi do të ofrohet nga e Hëna në të Premte në atraksione të ndryshme të Tiranës
3. Shërbimi do të ofrohet duke veshur kostume tradicionale të vendeve mesdhetare

Dokumenta aplikimi:

- CV
- Diplome ose vërtetim nga Fakulteti që është në ndjekje të studimeve
- Certifikate e gjuhëve të huaja

Aplikimet të dërgohen në adresën:

info@asetcenter.al brenda datës **10/04/2025 ora 16:00**

Cel. : **0693077364**